



ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Mars 2025

TAKIMI I NIVELIT TË LARTË MBI MASAT PËR ELIMINIMIN E TREGTISË SË PALIGJSHME TË PRODUKTEVE TË DUHANIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Genti Gazheli mori pjesë në Takimin e Nivelit të Lartë Ministror mbi masat për eliminimin e tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit në Ballkanin Perëndimor, i cili u mbajt në datën 13 Mars në Podgoricë.

Në fokus të diskutimeve gjatë këtij takimi, ku i pranishëm ishte dhe ministri i Financave i Shqipërisë, Petrit Malaj, si dhe drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, Ilir Binaj, ishte lufta kundër tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit në vendet e Ballkanit Perëndimor përmes masave të efektshme të kontrollit në pikat e kalimit kufitar dhe jo vetëm, ku autoritetet doganore kanë një rol të rëndësishëm krahas institucioneve të tjera ligjzbatuese dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në forcimin e sistemit të akcizës, për afrimin me kërkesat europiane dhe përmirësimin e masave për të luftuar aktivitetet e paligjshme në tregun e duhanit, përmes një qasjeje të integruar ndërinstitucionale, që përfshin administratën tatimore, doganat, institucionet e shëndetit publik dhe forcat e Policisë së Shtetit duke krijuar një mjedis të ekuilibruar dhe që garanton stabilitet tregtar të ndershëm dhe të sigurt. Gjatë takimit u dakordësua se bashkëpunimi mes vendeve të Ballkanit është i rëndësishëm për të forcuar kapacitetet e mbikëqyrjes dhe për të siguruar një treg më transparent.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE TAKOHET ME MISIONIN E BB

Një mision i Bankës Botërore zhvilloi ditën e hënë një vizitë pune pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ku u takua me Drejtorin e Përgjithshëm, Z. Genti Gazheli, për të vlerësuar progresin e projekteve me doganat. Ekspertët e BB vlerësuan në veçanti projektin National Single Window (Një Dritare e Vetme), si komponenti i parë që ndjek Projekti i Ballkanit Perëndimor për Lehtësimin dhe Thjeshtimin e Tregtisë dhe Transportit.

Lidhur me projektin e ri për Transitin e Kompjuterizuar Ndërkombëtar (New Computerized Transit System (NCTS), Z. Gazheli theksoi se do ta vendosë Shqipërinë krahas vendeve europiane për nga thjeshtimi i procedurave doganore. Edhe projekti i tretë me Bankën Botërore, ai i realizimit të Pikës së Përbashkët Doganore me Maqedoninë e Veriut në Qafë Thanë, për realizimin e procedurës me një ndalesë "One Stop Shop", ka lehtësuar më tej procedurat doganore në import dhe eksport nga të dy anët e kufirit.



DOGANA DIGJITALE




Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Mars 2025 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **530 shërbime online**.

PREZANTIMI I SISTEMIT ICS2 NGA EKSPERTËT E KOMISIONIT EUROPIAN TË DOGANAVE

Në datën 13 mars, DG TAXUD (Drejtorja e Përgjithshme për Tatimet dhe Bashkimin Doganor e KE), duke iu përgjigjur kërkesës së Administratës Doganore Shqiptare, organizoi një webinar ku ekspertët e Komisionit Europian zhvilluan një prezantim online për Sistemin ICS2. Në këtë prezantim morën pjesë operatorët ekonomikë të cilët u informuan në lidhje me aspektet operationale dhe teknike mbi sistemi ICS2, i cili nga 1 Prilli i këtij viti do të zëvendësojë sistemin ICS1 nëpërmjet një procesi krejtësisht të ri, në përputhje me Kodin Doganor të Bashkimit Europian.



Gjetjet kryesore të këtij prezantimi, i vlefshëm për të gjithë operatorët ekonomikë dhe transportuesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe që kanë marrë një numër EORI/RIOE në një nga vendet anëtare të BE, mund të aksesohet në dokumentin e mëposhtëm: <https://dogana.gov.al/dokument/5930/2025-03-13-ics2-webinar>

DREJTORI I DOGANAVE PRET ATASHEUN E RI DOGANOR PRANË AMBASADËS SË FRANCËS PËR EUROPËN JUGLINDORE DHE BALLKANIN

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli, priti sot në një takim Atasheun e ri Doganor pranë Ambasadës së Francës për Europën Juglindore dhe rajonin e Ballkanit, Z. Hugeus Chevalier, si dhe asistentin e tij, Z. Benjamin Offroy.



Të dy palët vlerësuan marrëdhëniet e ndërsjella në fushën e shkëmbimit të informacionit, si dhe asistencën teknike doganore. Në veçanti u vu theksi në mbikëqyrjen doganore në zonat portuale.

Përfaqësuesit e Doganës Franceze shprehën gatishmërinë për asistencën e mëtjeshme për strukturat doganore shqiptare në luftën kundër trafikëve të paligjshme.

VIZITË KORTEZIE E AMBASADORIT TË HOLANDËS NË SHQIPËRI REINOUT VOS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli, priti në një takim kortezie Ambasadorin e Hollandës në Tiranë, Z. Reinout Vos. Gjatë takimit, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli dhe Ambasadori Reinout Vos vlerësuan bashkëpunimin e shkëlqyer mes Shqipërisë dhe Hollandës sa i përket shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve.



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave i konfirmoi Ambasadorit Vos vendosmërinë e tij për të forcuar bashkëpunimin me bizneset hollandeze në vendin tonë. Ambasadori Reinout Vos siguroi Drejtorin e Përgjithshëm për vijimin e mbështetjes hollandeze dhe thellimin e bashkëpunimit të mëtejshëm bilateral.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli vlerësoi gjithashtu mbështetjen e vazhdueshme të Hollandës në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian.

VEPRIMI SEED+ FORCON STRATEGJINË E MENAXHIMIT TË RREZIKUT DOGANOR TË CEFTA-S 2025-2028

Veprimi SEED+, në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Agjencisë Italiane të Doganave dhe Monopoleve (ADM) dhe Drejtorinë Rajonale të Sicilisë, organizoi një seminar për ekspertët e menaxhimit të rrezikut doganor të CEFTA-s.



Seminari u fokusua në finalizimin e Strategjisë së Menaxhimit të Rrezikut Doganor të CEFTA-s për periudhën 2025-2028, duke integruar praktikat më të mira në nivel evropian dhe ndërkombëtar. Theksi u vendos në shfrytëzimin e teknologjisë për të rritur efikasitetin dhe sigurinë në lehtësimin e tregtisë, ndërkohë që administratat doganore të CEFTA-s harmonizohen me standardet e BE-së dhe avancojnë integrimin e CEFTA-s me Bashkimin Europian.

Si pjesë e programit, pjesëmarrësit vizituan Zyrën Doganore të Palermos, ku panë nga afër përdorimin praktik të pajisjeve skaner dhe laboratorin kimik të operuar nga ADM, duke marrë njohuri të vlefshme mbi teknikat e avancuara të kontrollit doganor dhe inspektimet e bazuara në rrezik.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM GENTI GAZHELI PRET AMBASADORIN E ITALISË MARCO ALBERTI

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Duke i shprehur mirënjohjen për Genti Gazheli, priti Sh.T. Z. Marco Alberti, Ambasador i Republikës së Italisë në Shqipëri. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi rëndësinë e drejtorit të Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli tha se vitet e fundit, bilaterale, me fokus të veçantë marrëdhëniet e doganave shqiptare me Italinë kanë njohur një zhvillim të vullshëm.



Ky takim i hap rrugën projekteve të reja të përbashkëta mes Administratave Doganore të Shqipërisë dhe Italisë dhe Guardia di Finanza, të cilat aktualisht janë në fazën e diskutimit për rinovimin e Plan Veprimit, si dhe të çuar akoma më tej bashkëpunimin mes dy anëve të Adriatikut. Dy bashkëbiseduesit vlerësuan rolin e veçantë që luajnë doganat e vendeve respektive, për lehtësimin dhe përshtetimin e lëvizjes së pasagjerëve dhe mallrave, si dhe në luftën e përbashkët kundër trafikëve të paligjshme.